



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Arsyetimi i Kryetarit të Komunës në lidhje me propozimin për shpalljen e “Qytetar Nderi” të z. Tomor Kotorri.

Tomor Kotorri ka lindur më 7 gusht 1961 në Krevoshë të Përmetit. Ka mbaruar Fakultetin e Bujqësisë, drejtimi Zooteknikë në Tiranë dhe më pas i është përkushtuar punës në këtë profesion. Mirëpo, Tomori nuk është kufizuar vetëm në profesionin e tij të specialistit të zooteknikës, por ka punuar me zell për përmirësimin e kushteve të jetës për banorët e zonës së Përmetit, si dhe është marrë aktivisht me ruajtjen dhe kultivimin e vlerave kombëtare në zonën ku jetonte e më gjerë në viset shqiptare.

Duke qenë Kryetar i Komunës Frashër për dy mandate (2003 – 2011), Tomori është marrë aktivisht me lartësimin e emrit dhe veprimtarisë së vëllezërve Frashëri, duke organizuar tryeza, simpoziume dhe veprimtari të tjera kombëtare në përpjekje për të ruajtur e kultivuar kulturën dhe traditën kombëtare. Ka punuar shumë që vendlindja e vëllezërve ideologëve të Rilindjes tonë kombëtare e drejtuesve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të shndërrohet në një zonë muzeale që vizitohet me dëshirë të madhe nga dashamirësit e kulturës dhe historisë tonë kombëtare. Këto aktivitete z. Kotorri nuk i ka kufizuar vetëm brenda territorit administrativ të bashkisë së Përmetit, por ka bashkëpunuar edhe me veprimtarë e studiues të shquar në Tiranë, por edhe jashtë kufijve administrativ të Republikës së Shqipërisë.

Bashkëpunimi i z. Kotorri me veprimtarë të komunës së Rahovecit, Therandës, Prizrenit, Tetovës, Ulqinit dhe viseve të tjera shqiptare, ka sjellë si rezultat binjakëzimin – vëllazërimin e disa shkollave e komunave me Bashkinë e Përmetit. Ndër këto binjakëzime është edhe ai i Komunës së Rahovecit me Bashkinë e Përmetit, miratuar edhe nga Kuvendi i Komunës në vitin 2017.

Është themelues dhe drejtues i shoqatës atdhetare “Vëllezërit Frashëri”, shoqatë që për gati dy dekada merret me organizimin e ngjarjeve kulturore e historike më 25 maj, në ditëlindjen e rilindësit tonë të madh Naim Frashëri. Si rezultat i punës së përbashkët me shkollat në Republikën e Kosovës dhe të atyre të Republikës së Shqipërisë janë mbajtur shumë aktivitete vjetore në nder të veprimtarisë së vëllezërve Frashëri, por edhe të atdhetarëve të tjerë nga vise të ndryshme shqiptare.

Falë punës e përkushtimit të z. Kotorri është arritur binjakëzimi i Shkollës Filllore të Mesme të Ulët “Mustafë Ibishi” në Kramovik të Rahovecit me Shkollën nëntëvjeçare “Nonda Bulka” në Përmet, bashkëpunim që funksionon edhe sot. Kontribut të vyer në vendosjen dhe thellimin e bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Përmet dhe Komunës së Rahovecit ka dhënë dhe po jep shoqata kulturore-artistike “Zëri dardan” në Kramovik, me drejtues Egzon Thaçi, Bekim

Kelmendi dhe Jemin Thaçi, si dhe i ndjeri Miftar Thaçi, ish-drejtor i shkollës “Mustafë Ibishi”, kontributi i të cilëve duhet vlerësuar.

Bazuar në këto fakte, propozoj që: z. Tomor Kotorri të shpallet “Qytetar nderi i Komunës së Rahovecit”, me këtë motivacion:

PËR RUAJTJEN DHE KULTIVIMIN E VLERAVE KOMBËTARE SHQIPTARE, PËR KULTIVIMIN E FRYMËS ATDHETARE E VËLLAZËRORE NDËRMJET BASHKISË SË PËRMETIT DHE KOMUNAVE TË TJERA JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE PËR KONTRIBUTIN ATDHETAR PËR KTHIMIN E FRASHËRIT NË NJË QENDËR HISTORIKE, TURISTIKE E MUZEALE DHE VEND PELEGRINAZHI PËR VIZITORËT, SI DHE PËR KONTRIBUTIN E DHËNË NË BINJAKËZIMIN/VËLLAZËRIMIN E BASHKISË SË PËRMETIT ME KOMUNËN E RAHOVECIT DHE PËR BASHKËPUNIMIN VËLLAZËROR.

Duke e miratuar këtë propozim, i kontribuojmë kultivimit të frymës atdhetare, bashkëpunimit vëllazëror, si dhe motivimin e veprimtarëve nga vise të ndryshme shqiptare për zgjerimin e komunikimit ndër-shqiptar nga të gjithë hapësirën ku jetojnë e punojnë shqiptarët.

Ju faleminderit!



01 Nr. 01/20
Rahovec, 01.10.2020

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 01/109 Nr. i faq./Br.str./No.pg 1
Data/Datum/Date 29 09 2020

Në bazë të nenit 51.12 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës 03/L-040, nenit 4 pika 2 të Ligjit për Hoçën e Madhe, nenit 3 të Udhëzimit Administrativ nr. 11/2014 për themelimin, zgjedhjen, përgjegjësitë dhe funksionimin e Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe dhe Vendimit 01 Nr.1031 për themelimin e Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, shpall këtë:

Ftesë Publike **Për zgjedhjen dhe zëvendësimin e anëtarit/es të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe**

Këshilli i fshatit Hoçë e Madhe përbëhet prej 5 anëtarëve, gjegjësisht 2 qytetarë të Komunës së Rahovecit - shqiptar; 2 banorë të fshatit Hoçë e Madhe dhe një nga Kisha Ortodokse Serbe, i cili duhet të jetë banor i fshatit Hoçë e Madhe.

Përgjegjësitë e Këshillit, ndër të tjera, kanë të bëjnë me mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë fetare dhe kulturore si dhe planifikimi hapësor dhe rural të fshatit Hoçë e Madhe.

Ftohen të interesuarit që të konkurrojnë për anëtarë/e të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe.

Preferohet që aplikantët të kenë përvojë në lëmitë vijuese:

- Ruajtjen, zhvillimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të fshatit Hoçë e Madhe, si dhe të komunës së Rahovecit në tërësi,
- Gjithashtu, preferohet që anëtari/ja e Këshillit të kenë kualifikime relevante-superiore siç janë: arkitektë, historianë, arkeologë, gjeografë ose pjesëtarë të OJQ-ve të ndryshme të cilat mirën me njohjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Aplikacionet, që përbëhen nga kërkesa, CV-n dhe dëshmitë për përvojën tuaj në lëmitë e theksuara më lartë, duhet t'i dorëzoni në Zyrën e pranimit të KK-së, duke cekur për Kryesuesin e Kuvendit të Komunës së Rahovecit.


Ftesa mbetet e hapur 15 ditë nga dita e publikimit të saj ne veb.faqen zyrtare te komunës si dhe në mjetet e informimit.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit, respektivisht pas datës 15 tetor 2020, nuk do të merren në shqyrtim.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **27.08.2020**, me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes, i nderuar Kryetar i Komunës z. Smajl Latifi, nënkryetar i Komunës z. **Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të mediave dhe ju gjithë të pranishëm!

Për këtë mbledhje sot propozojmë këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Pasqyrave Financiare të Komunës së Rahovecit,
4. Rishqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për bartjen e mjeteve nga rezervat e buxhetit komunal, nga kategoria e pozicionit të pagave në kategorinë e investimeve kapitale,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-71510057-07998-0 në Rahovec,
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-71510057-04475-0 në Rahovec,
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-71510057-04381-0,
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për emërtimin e Muzeut të Qytetit “Ali (Bajram) Hasku”,
9. Shqyrtimi dhe aproyimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shfuqizimin e vendimit 01-Nr.90/20 të datës 29.07.2020 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë.

Të nderuar kuvendarë, para se ta aprovojmë rendin e ditës, propozoj dhe kërkoj nga ju që pikën e katërt të rendit të ditës ta trajtojmë apo ta bartim në pikën e tretë dhe pikën e tretë ta kalojmë në pikën e katërt, për shkak që drejtorisë së Financave i duhet detyrimit sot të udhëtojnë për Ministri që me pas vendimin e gatshëm. Atëherë e qesim në votim rendin e ditës. Konstatojmë se unanimisht aprovohet rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

A ka dikush diçka rreth pikës së parë, nëse jo e qesim në votim. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

4. Rishqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për bartjen e mjeteve nga rezervat e buxhetit komunal nga kategoria e pozicionit të pagave në kategorinë e investimeve kapitale.

Afrim Limani – Përshëndetje për ju kryesues, kryetar, nënkryetar, ju asambleistë dhe gjithë ju të pranishëm. Në fakt kjo pikë e rendit të ditës, pra bartja e fondit rezervë ka kaluar në një seancë të jashtëzakonshme më herët. Mirëpo për shkak të rishikimit të buxhetit në kuadër të nivelit qendror, pra shuma e cila ka qenë prej 1,370,000 euro, pra një sasi me vlerë prej 93,595 euro është zbritur, kështu që sipas ligjit detyrimit duhet të dalim prapë në Kuvend. Arsyeja pse është zbritur shuma është sepse këtë shumë e kanë bartur në pozicionin e pagave dhe mëditjeve në kuadër të organizatës tonë, e cila shumë gjatë muajit shkurt dhe mars, për shkak të pandemisë nga kjo vlerë janë paguar punëtorët e shëndetësisë, zjarrfikësve dhe të inspektionit. Vlera për bartje tani është 993,344 euro d.m.th. nuk ka ndryshuar në kuadër të projekteve të mëhershme që kemi pasur por vetëm që kemi shkuar në reduktim pra zbritje të vlerave të kësaj shume. Ju falënderoj shumë juve për këtë mirëkuptim dhe kërkoj nga ju që ta votoni këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, pikërisht me datën: 09.08.2020 kemi pasur mbledhjen e jashtëzakonshme, pikërisht për këtë pikë të rendit të ditës dhe siç e shpjegoj edhe drejtori për shkak të rishikimit të buxhetit, ne duhet që ta aprovojmë prapë këtë pikë të rendit të ditës. A ka dikush diçka që dëshiron me marrë fjalën dhe nëse nuk kemi e qesim në votim pikën e dytë të rendit të ditës. Konstatojmë se unanimisht aprovohet pika e dytë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.

Ali Zhuniqi – Pyetja ime i adresohet drejtorit të arsimit në lidhje me një konkurs i cili është hapur për lëndën e gjeografisë dhe për orët që janë shpallur aty, fjala është për një arsimtar i cili ka pasur të siguruara orët dhe ka pasur kontratë deri me 31 të këtij muaji edhe duke pasur parasysh se personi në fjalë ka pasur përgatitje profesionale për llojin e punës dhe po ashtu ka edhe licencë për punën që e bën aty dhe nga ana e drejtorit ka marrë vlerësimet maksimale si arsimtar i përgjegjshëm. Atëherë pse drejtor keni hapur një konkurs të jashtëm kur personi në fjalë për dy vite ju ka vazhduar kontratën ndërsa për një kohë të caktuar ja keni ndërprerë kontratën. A ka mundësi me na dhanë sqarime rreth kësaj?

Fehmi Cena - Përshëndetje kryesues për ju, kryetarin, nënkryetarin, drejtorët, kolegë këshilltarë dhe gjithë që janë prezentë në këtë sallë. Pyetja ime i adresohet kryetarit të Komunës, ku në njërin nga mbledhjet e kaluara të Kuvendit Komunal me kërkesën e Kryetarit të Komunës e kemi votuar një nismë për bashkëpunim komunal ndërmjet komunës së Rahovecit dhe komunës së Gjakovës si dhe Ministrisë së Pushtetit Lokal në lidhje me investimet infrastrukturore për rregullimin e pendës tek Ura e Fshejtë. Pyetja ime është se a është punuar diçka në këtë drejtim dhe nëse po deri ku kanë shkuar këto punime?

Dervish Çadraku – Përshëndetje për të gjithë, unë kam një pyetje pasi qytetarët pyesin për gjendjen e pandemisë Covid-19 dhe pyetja për kryetarin është se ata që janë të diagnostifikuar me Covid-19, a e kanë për obligim mjekët ose punëtorët shëndetësorë pra QKMF-ja që ti vizitoj në shtëpi apo duhet të vijnë ata që ti marrin shërbimet në ambulantë sepse tash me krijimin e ligjit të ri atëherë një i infektuar që del në rrugë do të dënohet me gjobë me mijëra euro. Dhe nëse ndodh kështu dhe njerëzit dalin edhe i marrin shërbimet në ambulantë atëherë shfaqen dy rreziqe, pra i pari është se ata mund të dënohen dhe i dyti që mund të infektjnë edhe të tjerët. A e kanë për obligim që të shkojnë mjekët atje dhe të japin shërbimet e duhura. Faleminderit!

Trajko Shariq – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Çështjen që dua të ngris është në lidhje me problemet infrastrukturore në lagjen e epërme gjegjësisht me ujërat e zeza pra problemet me kanalizim tek qeshmja pasi ka mbi një vite që nuk po zgjidhët ky problem. Gjithashtu është problemi i ndriçimit publik ku dita ditës ka probleme edhe me të mëdha edhe nuk po zgjidhen ato.

Munib Durguti – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Unë desha me ngritë shqetësimin ditëve të fundit rreth infrastrukturës rrugore të shkaktuara nga të reshurat e mëdha të shiut, ku kemi shumë rrugë në qytet dhe nëpër fshatra që vërshohen dhe krijojnë probleme të mëdha e po ashtu edhe në ekonomitë familjare. Kërkesa ime konkrete do të jetë që për vitin 2021 komuna a do ta trajtoj këtë problematike që të evitoj këto probleme me ndonjë projekt konkret e sidomos nga semafori e deri te stacioni i autobusëve. Ky problem nuk po them që tani është krijuar por ky problem me dekada përcillet çdo vit. Po ashtu janë edhe disa rrugica të cilat me një investim të vogël mund të trajtohen dhe të përmirësohet gjendja e tyre dhe kërkoj nga drejtori i shërbimeve publike që të jetë më aktiv pasi tani jemi në periudhën ku shirat janë ende kërcënim i madh dhe me një afat të caktuar që trajtohen këto rrugë dhe rrugica.

Shqipe Kryeziu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Pyetja ime i adresohet drejtorit të arsimit që me na dhanë një sqarim në pika shume të shkurta se a ka fillua me dezinfektimin e shkollave që do të filloj procesi mësimor dhe a është i përgatitur edhe për shenjëzimin e nxënësve për distancën, pra kërkojmë një sqarim të vogël rreth kësaj, pasi besoj që për këtë punë është marr edhe kryetari rreth fillimit të procesit mësimor.

Aferdita Thaqi – Përshëndetje për të gjithë. Unë kam një kërkesë që të largohen këto lista pasi ato barten nga njeri te tjetri dhe munden me qenë burim i përhapjes së infeksionit dhe kërkoj që të anulohen këto lista për shkak të pandemisë.

Sali Sallteku – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Siç e potencoj edhe parafolësja që ta keni parasysh këtë dhe po ashtu edhe ju kryesues duhet që mbledhja të kryhet sa më shpejt pasi jemi në numër të madh në sallë të kuvendit dhe mendoj se kjo është kërkesë e të gjithëve pasi jemi në gjendje të jashtëzakonshme edhe me krye sa më shpejt që është e mundur për shkak të gjendjes së pandemisë.

Ali Zhuniqi – Mëqenese jemi në prag të fillimit të procesit mësimor kisha kërkuar sqarim nga ana e drejtorit të arsimit e poashtu edhe nga ana e Kryetarit të Komunës që sigurisht edhe duhet me ditë, se a keni mundur me identifikua se sa arsimtar eventualisht janë të prekur me Covid-19 edhe i kanë bërë parapërgatitjet sa i përket ambientit të objekteve shkollave.

Kryetari – Përshëndetje kryesues, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendit, ju që përcjellni mbledhjen e rregullt të Kuvendit komunal. Për konkursin e jashtëm do të përgjigjet drejtori i arsimit në seancën e ardhshme të kuvendit komunal pasi janë çështje që i din DKA-ja. Ne do të i përgjigjemi konkretisht dhe shumë shkurt, rreth memorandumit të mirëkuptimit me komunën e Gjakovës për projektin infrastrukturor respektivisht për ndërtimin e pendës tek Ura e Fshejtë, ka qenë një aplikim në Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal para një viti e gjysme apo dy vite mirëpo ka dështuar ai projekt. Pyetja nga asamblesiti Dervish Çadraku, njerëzit apo qytetarët që janë të infektuar me virusin Corona dhe që janë të izoluar dhe që marrin shërbimet mjekësore QMF dhe AMF, në qoftëse ata janë të mbrojtur edhe me maska, shërbimet tona i japin mjekët infermieret dhe ata që i japin janë të mbrojtur për shkak se i kanë maskat dhe dorëzat. Kjo është terapi që e japin mjekët dhe infermieret tanë pasi kontaktet janë të vazhdueshme çdo ditë me kërkesën e tyre me mjekët dhe infermierët edhe sigurisht së vijnë edhe të shtëpia e kryejnë shërbimin por sigurisht mund të bëjnë edhe në ambulatat apo QMF-të me të afërt sipas rastit apo nevojës. Tek reshjet e mëdha dhe vërshimet që shkaktohen shirat e rrëmbyeshëm që e kaplojnë qytetin dhe që tash në kohë të fundit janë të shpeshta, ne tani e kemi në vlerësim tenderin për hapjen e kanalit me beton apo ndërtimin e kanalit me beton prej Lab-oil e deri te lumi Dullo i cili është një projekt që shpresojmë që sa më shpejt me ja nis. Për rrugicat dhe rrugët, ato ndërhyrje ne kemi kontratë me kompaninë për intervenime emergjente por nganjëherë s'po kemi edhe mjete financiare. Në pyetjen e parashtruar nga Trajko Shariq te ndriçimi publik në lagjen e epërme dhe trajtimin e ujërave të zeza, që kemi nganjëherë probleme dhe ballafaqime me mungesë të mjeteve financiare por e rëndësishme është kemi kontratë dhe ne rastin e parë do të ndërhyjmë në lagjen e epërme në dy aspektet pra

edhe ne ndriçim publik por edhe në ujërat e zeza dhe jo vetëm aty por çdo vend ku ka mundësi kompania për ndriçim publik është duke punuar dhe sigurisht që janë duke shkuar me radhë duke pasur parasysh edhe mungesën e kapaciteteve që me fillua në të njëjtën kohë në 3-4 vende lagje apo fshatra edhe besoj që jemi në ecuri sa i takon ndriçimit publik dhe ujërave të zeza. Ne sot kemi mbajtur një takim me drejtorët e shkollave dhe koordinatorët e cilësisë bashkë me drejtorin e arsimit dhe objektet do të dezinfektohen dhe pas dezinfektimit do të filloj procesi edukativo arsimor në shkollat tona prej parashkolloreve sipas masterplanit që ka paraparë Ministria e Arsimit dhe Shkencës e cila është në koordinim të plotë edhe me institucionet tjera si Ministrinë e Shëndetësisë dhe instrumentet apo mekanizmat tjerë që kujdesen për mbarëvajtjen apo fillimin e mbarë të procesit edukativo arsimor në shkollat tona duke ju përshtatur kushteve të pandemisë, duke ditur se çka nëse infektohet një mësimdhënës apo nxënës duke ditur se rreziku është i madhe por ne të gjitha përgatitjet jemi duke i bërë dhe jemi në finale natyrisht dhe ditën e parë kur të fillon mësimi ne ato shkolla nuk do hyn askush në shkolla as nxënësit mësimdhënësit apo drejtorët pa qenë e dezinfektuar dhe sigurisht që përgjegjësia është e jona pra e shtetit dhe sigurisht që kemi kërkuar që ta marrin një pjesë të përgjegjësisë edhe drejtoret dhe organet drejtuese të shkollave për t'i respektuar maksimalisht masat dhe rekomandimet udhëzimet manualin dhe rregullat si masë mbrojtëse për parandalimin se përhapjes se infeksionit. I kemi edhe katër ditë në dispozicion po ashtu edhe për testin e maturës jemi përgatitë në ato shkolla ku do të mbahet testi i maturës do të respektohen këto kritere, pra jam dakord për të gjitha ato që i ngriti Shqipe Kryeziu dhe Ali Zhuniqi, normalisht që edhe ne jemi dakord me fillua procesi edukativo arsimor në kushte pandemie por normalisht duke u bazuar në skenarë dhe gjithë atyre që i frekuentojnë objektet shkollore është prioritet e po ashtu krahas kësaj është edhe funksionimi i jetës pasi virusi ekziston dhe vret dhe sikurse edhe vendet tjera edhe te ne duhet me gjet forma për me vazhdua që me funksionua jeta edhe ne si shoqëri edhe investimet, edhe arsimi pastaj shëndetësia që të gjitha duhet me funksionua duke u përshtatur me kushtet dhe rrethanat e reja që i ka imponue pandemia. Unë nuk po shoh diçka tjetër edhe nuk po dua me zgjat më shumë, për të gjitha shqetësimet që i ngriti Afërdita ka forma dhe modalitete por nënshkrimet duhet me u kon për shkak se është rregull. Faleminderit shumë!

Kryesuesi – Faleminderit shume kryetar për informacionet, të nderuar kolegë kuvendarë, kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të Pasqyrave Financiare të Komunës së Rahovecit.

Afrim Limani – Përshëndetje për të gjithë. Auditimi i Pasqyrave Financiare të Komunës së Rahovecit për vitin 2019 ka dalë pra ka rezultuar pozitiv apo i modifikuar në theksim të çështjes. Për dallim prej viteve tjera në të cilën theksimi i çështjes është kryesisht ne disa pika, kësaj here theksimi i çështjes është kuadër të një pike dhe lirisht mund të ju them se është një prej raporteve me te mira në komunën e Rahovecit. Me këtë ne nuk duhet të jemi të kënaqur pasi akoma ka hapësire dhe vend për përmirësime të mëtutjeshme sepse vet rekomandimet që janë 14 rekomandime që janë disa rekomandime që na kanë ikur për shkak se ndoshta kemi mundur me i zbatua. Krejt materiali pra përmbajtja e këtij materiali është e theksuar me 14 rekomandime në fund të këtij raporti që për dallim prej viteve të kaluara kemi ne minus rekomandime pra 14 rekomandime. Unë më tepër nuk dua të zgjatem por ju lë hapësirë juve për pyetje.

Florida Bajraktari – Përshëndetje për të gjithë. Raportin e auditimit për pasqyrat financiare për komunën e Rahovecit e kam lexuar me vëmendje dhe unë pashë disa çështje që i ka cekur auditori por unë do të ndalem te faqe 10 tek çështja A1 keq klasifikimi i shpenzimeve. Sipas Auditorit të Përgjithshëm për shkak të auditimit të dobët, për të audituar të gjitha shpenzimet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, komuna jonë nga investimet kapitale ka paguar 120,000 euro për mallra dhe shërbime. Gjithashtu në bazë të vendimeve të gjykatës përmbartimore, vlera prej 105,373 euro është regjistruar në kategoritë ekonomike jo adekuade. Nga investimet kapitale dhe nga mallrat dhe shërbimet janë paguar 72,010 euro për paga jubilarë dhe përcjellëse ndërsa për mallrat dhe shërbimet janë paguar 33,363 euro për investimet kapitale. Është mirë që në të ardhmen të bëhet planifikimi i mirë i buxhetit nëpër kategoritë ekonomike në mënyrë që të mos kemi vërejtje nga

Auditori i Përgjithshëm për keq klasifikim të shpenzimeve. Pastaj tek çështja C3 faqe 14 sipas Auditorit të Përgjithshëm kemi pagesa të shpenzimeve para marrjes së shërbimit dhe mos dokumentimi i tyre.

Fehmi Cena – Përshëndetje për të gjithë. Raporti i Auditimit të pasqyrave financiare të komunës së Rahovecit për mua është i qartë dhe është interpretuar në 3 hallka kryesore: ne pasqyrat financiare vjetore, menaxhimi financiar dhe kontrolli dhe zbatimi i rekomandimeve. Konkluzionet e auditorit janë se edhe përkundër asaj që janë shënuar përmirësime dhe janë marr parasysh edhe disa sugjerime të mëhershme, megjithatë edhe raporti ka mjaft të gjetura të parregullta dhe mbi këtë bazë edhe ZKA-ja ka dhënë 14 rekomandime. Në krahasim me vitin paraprak që ishin 21 mirëpo megjithatë në vete ngërthen një parregullsi dhe çështje të ngritura. Në të gjitha hallkat financiare ku është bërë auditimi ka gjetje të parregullta dhe çështje të ngritura veç rezultateve dhe rekomandimeve brenda. Më shqetësuese për ne delegatët është shumica e këtyre çështjeve po përsëriten vite pas viti dhe për pasojë edhe po janë edhe rekomandimet e njëjta. Unë dua t'i diskutoj disa çështje me radhë dhe po filloj nga faqja e 10-të, tek planifikimi dhe realizimi i buxhetit, që u ngritë edhe nga parafolësja si çështje A1 që korrespondon me rekomandimin 1 si keq klasifikimi i shpenzimeve, që u cekë ajo shuma goxha e madhe prej 225,373 euro që ka qenë në keq klasifikim ku janë përzier jo vetëm kodet buxhetore por edhe kategoritë që janë shpenzuar si kontratë 120,000 për shërbime dhe mallra nga investimet kapitale, pastaj afër 105,000 për paga jubilarë. Por ajo që është shqetësuese për mua si delegatë është obligimi shtesë që ka hy komuna për shkak të procedurave përmbartimore gjyqësore prej 14,406 euro shtesë që nuk ka qenë e planifikuar, e kjo tash në planifikim jo të mirë dhe të dobët dhe shpenzim jo të drejtë ashtu siç ceket edhe nga auditori. Tek shpenzimet e fondeve në raport me burimet e fondeve për këtë vit pra për vitin 2019 është me mirë ne raport me vitin 2018, shpenzimet kanë qenë diku 97% që është ne rregull. Tek të hyrat çështjen 1 po e potencoj që korrespondon me rekomandimin 2, numër i madhe i ankesave të bazuara nga qytetarët nga shërbimi në tatimin pronë, ku kemi diku 221 ankesa nga qytetarët dhe vetëm 9 kanë qenë pabazuara pra shumica kanë qenë bazuara pra të shikohet që në këtë shërbim të bëhet puna me drejtë në mënyrë që vlerësimi i pronave të paluajtshme është mangësi në menaxhimin në personel. Përsëri është një çështje që po përsëritet te drejtoria për siguri dhe emergjencë ku auditori thotë se nuk ka kosto të mjaftueshme sidomos te aty potencohet për kornizat shtesë që unë mendoj se ato paguhen prej buxhetit komunal dhe për mua nuk është e qartë se pse auditori nuk ka qasje në ato shpenzime shtesë për punëtorët e kësaj drejtorie. Mallrat dhe shërbimet janë të ngritura, që është çështje e investimeve kapitale janë të ngritura pra dy çështje që unë mendoj se janë mjaft serioze. Te pasuritë kapitale dhe jo kapitale gjithashtu kemi dy çështje që pastaj vijnë edhe rekomandime dy, llogarite të arkëtueshme gjithashtu kemi dy çështje, funksionimi i auditorit të brendshëm gjithashtu ka vërejtje edhe kjo po përsëritet gjithashtu dhe ne e dimë rolin e auditorit të brendshëm se cili është. Tash unë nuk dua të ndalem në të gjitha çështjet hollësisht me i debatue me i diskutue pasi ato janë të shkruara qartë dhe mendoj se për shkak të kohës se janë edhe delegat tjerë që do të diskutojnë, por ajo çka dua të them është kështu, pasi qeveria lokale ka nevojë për përmirësime në bazë të këtij auditimi sidomos në planifikimin me të mirë të buxhetit dhe shpenzim me të drejtë. Qëllimi është që paraja publike të shpenzohet sa më drejtë dhe të shkojë aty ku duhet pra drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së qytetarit.

Hanalora Hoti – Faleminderit kryesues. Unë desha të lidhem te pika mallrat dhe shërbimet përkatësisht tek çështja C2, ku thuhet se ka vonesa në pagesën e faturave të cilat variojnë nga 5-10 muaj, që janë pikërisht 4 faturat e vitit 2018 me vlerë prej 29,299 euro dhe tetë fatura të vitit 2019 me vlerë prej 21,750 euro që kanë rezultuar me vonesa në pagesë duke kaluar kështu afatet kohore. Tjetër pikë që desha me u lidhe është investimet kapitale që është çështja B2 ku janë kontratat e nënshkruara për projekte infrastrukturore ku në bazë të të gjeturave thuhet se vlera e kontratave të nënshkruara i përfundojnë shumatat e parapara me ligjin e buxhetit, që janë 3 projekte dhe njeri prej tyre është Ndërtimi i rrugës me katër korsi nga Rahoveci deri në Xërxe për vitin 2019 dhe dy vitet pasuese që janë paraparë me vlerë prej 3,400,000 euro ndërsa janë

nënshkruar 3 kontrata me lote 1,2 dhe 3 me vlerë prej 6,513,954 euro, ku janë parapare 800,00 euro ndërsa kontrata është nënshkruar me vlerë prej 898,888 euro, diferencë prej 98,888 euro pra edhe kjo shumë është e pambulueshme nga ligji i buxhetit. Të gjitha këto kanë ndodhur për shkak të vlerësimeve jo reale të kostove financiare të projekteve me rastin e buxhetimit të tyre.

Dervish Çadraku – Faleminderit kryesues, edhe unë nuk do të zgjatem shume pasi shumëçka u tha edhe sigurisht nuk do të dal me i mençur se auditimi sepse vërejtjet që i kanë bërë auditorët në materialin që i kanë marr nga komuna janë të mjaftueshme për ju që me i pa gabimet se ku i keni bërë dhe drejtori tha se jemi mirë pasi kemi pasur 21 vërejtje kurse tash kemi 14-të por ende kemi vërejtje të mjaftueshme për me qenë të shqetësuar që me punua ma mirë edhe me pas koordinimin ma të mirë. Unë po i përmbledhë të gjitha vërejtjet e juaja në 4-5 pika që mos me shkua shume gjatë, pra kemi keq menaxhimin e shpenzimeve ku kemi 330,736 euro të keq klasifikuara pastaj kemi numrin e madhe të ankesave 220 ankesa që vetëm 9 janë të arsyeshme, pastaj kemi problem e punëtorëve të emergjencës që punojnë, pastaj kemi pagesat para se të kryhen shërbimet që kjo vazhdimisht po na përcillet, pastaj kontrata pa sigurimin e mjeteve pra edhe kjo u bë si praktike me fjalë. Pra institucioni i fjalës kryeni ju punën pastaj unë do të jap paratë, pra një lloje marrëveshje e pune kryesit me stafin tuaj, pra kjo nuk është mirë pasi shtetit nuk funksionon ende si duhet me ligjet dhe rregullat që i ka por jo me institucionin e fjalës. Pra si përmbledhje e mora që janë këto vërejtje që auditori na ka dhënë vazhdimisht por si staf ende nuk është në gjendje me i përmirësua këto gabime apo vërejtje që janë, në mënyrë që mos me u përsëritë. Prandaj unë kisha dhënë si vërejtje që të punoni edhe më tepër, edhe t'i heqim edhe këto vërejtje sepse nëse këto përsëriten atëherë është një menaxhim i keq i komunës.

Masar Popaj – Përsëritet për të gjithë. Shqyrtimi i raportit të progreseve për zbatimin e rekomandimeve 30 Shtator dhe 15 mars, sipas kërkesave të dala nga rregullorja e punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit sipas zyrtareve të komunës 15 rekomandime janë të zbatuara, 4 janë të zbatuara pjesërisht dhe të tjerat do të zbatohen në vitin 2020. Megjithatë gjendja nuk qëndron kështu nga këto konstatime. Raporti i auditimit tone për vitin 2020, 15 rekomandime janë zbatuara, 2 janë të mbyllura, 20 janë në proces të zbatimit dhe 3 nuk janë ende.

Ali Zhuniqi – unë veç desha me kërkuar arsyen me pyetjen paraprake që bëra në fillim të seancës, së cila është arsyeja me ma dhanë përgjigjen në mbledhjen e ardhshme në lidhje me konkursin që është shpallur për lëndën e gjeografisë. Pasi të kryhen këto me shqetësimet që shprehen kolegët kuvendarë në lidhje me raportin e auditimit, kisha dashtë mundësisht me u përgjigje në lidhje me pyetjen.

Kryetari – Faleminderit shume, falënderoj prezencën e familjareve të atdhetarit Ali (Bajram) Hasku dhe në mbledhjen rregullt të Kuvendit Komunal parashihet në rend dite të jetë edhe vendimi i komisionit të Kryetarit të Komunës për emërtimin e Muzeut të Qytetit, Ali (Bajram) Hasku. Faleminderit për diskutimet, në parim diskutimet ishin të frytshme, e vërteta është se pak ditë me herët të gjitha raportet prej se ka filluar auditimi i kam përcjellë sepse i kemi të publikuara në webfaqe. Vërtetë është se Auditorët e Jashtëm apo Zyra Kombëtare e Auditimit ka për detyrë se është kontrollë i lartë i shtetit dhe ka për detyrë me sfidua menaxhmentin apo institucionin drejtues dhe vazhdimisht do të ketë të gjetura, dhe këto të gjetura të cilat i kemi dhe këto rekomandime, që tash e kemi raportin e pasqyrave pra raportin e auditimit kombëtar për komunën e Rahovecit, pra raporti final ka me pak keq klasifikime, ka zbatim të rekomandimeve, ka rekomandime që po zbatohen pjesërisht nëse bahen krahasime me raportin e vitit të kaluar për vitin 2018, ka rekomandime të përsëritura të cilat nuk varen fare prej komunës së Rahovecit siç është fjala me zjarrfikësit. Në të gjitha komunat e Kosovës, pra në 38 komunat e Kosovës kanë rekomandim për zjarrfikësit, padrejhtësisht se është një mekanizëm i presionit që e përdorë zyra kombëtare e auditimit që me gjasë vitin 2021 do të përfundon ky proces dhe më nuk do të ketë rekomandim për zjarrfikësit. Pra në nuk jemi autoriteti që vendosim për zjarrfikësit por është agjensioni i menaxhimit të emergjencave pra neve as dosjet e punëtorëve

nuk kanë obligim me na dhanë edhe pse i kemi kërkuar dhe mëzi i kemi sigurua. Për sa i takon planifikimit të buxhetit, që ju e dini mirë se planifikimin e buxhetit e bënë udhëheqja komunale pra ekzekutivi i komunës në bashkëpunim me Kuvendin e Komunës, Dëgjimet publike, debatet publike, Komiteti për Politikë dhe Financa etj. dhe nëse dikush thotë se ka planifikim të dobët të buxhetit që nuk është e vërtetë, pasi planifikimi është maksimalisht i mirë dhe në përputhje me rrethanat dhe mundësitë buxhetore dhe në përputhje me kërkesat në rritje dhe nevojat që i kanë në vazhdimësi qytetarët e komunës së Rahovecit. Nëse flasim për procedurën përmbartimore, që kush është jurist e din më se mirë këtë, pasi përmbartuesi nuk pyete ty pasi ku të gjene mjetet të mira ti merre edhe na i ka marrë dhe nëse flasim për paga jubilarë sigurisht që na merr edhe pagat jubilarë sepse edhe këtu në Kuvend të Komunës ka arsimtarë që sigurisht ka edhe qindra të tjerë që dëshirojnë me respektua kontratën kolektive që është dëshirë edhe e jona dhe nuk kemi një zgjidhje shume të admirueshme dhe nuk kemi mundësi që të përballemi suksesshëm që ti paguajmë ne pagat jubilarë sipas kontratës kolektive mësimdhënësve. Dhe tash këtë përballje që ka komuna me kërkesat legjitime që i kanë mësimdhënësit që kërkojnë pagat jubilarë edhe janë që ti marrin pra ti marrin edhe me gjykatë edhe me përmbartuesin. Dhe unë jam për me krye punë e sigurisht me ju nderua edhe juve sepse jeni përfaqësues të zgjedhur edhe qytetarëve që kërkojnë. Pra vazhdimisht le të me japin rekomandimin për mungesën e mjeteve financiare edhe për kontrata edhe me të mëdha. Pra unë nuk jam ardhë për me filozofua këtu por jam zgjedhë që me ju shërbye qytetarëve për kanalizim, ujera të zeza, rrugëve pra projekteve të ndryshme të cilët ata kanë nevojë e për çka edhe na jemi të zgjedhur. Për 3 kontrata të cilat i përmendi Hanalora, e vërteta është një gabim i zyrës kombëtare të auditimit që e ka konstatua gabimin tonë, pra këto janë kontrata që financohen nga qeveria e Kosovës dhe ne kemi memorandume të mirëkuptimit të nënshkruara edhe për rrugën katër korsi, edhe për rrugën Rahovec-Hamoc-Forësë edhe për rrugën Xerxë-Sopniq-Ratkoc. Ne i kemi të verifikuara me nënshkrime dhe të vërtetuara natyrisht me ligjin për buxhete dhe nëse nuk i kanë paraparë për këtë vite atëherë i parashohin për vitin 2021 dhe gabimi jonë është se pse ne nuk e kemi bërë komentimin që me saktësua këtë çështje. Pra ky rekomandim për këto 3 kontrata ose ky konkluzion ose kjo e gjetur realisht nuk ekziston për shkak se ne nuk financojmë nga buxheti komunal. Te planifikimi i të hyrave, natyrisht edhe tek sektori i tatimit në pronë ka nevojë për korrigjime dhe me ju përgjigj atyre ankesave që kanë dalë të bazuara ankesat e qytetarëve. Vlerësimet për prona gjithmonë edhe natyrisht për çdo ditë ka nevojë për me u korrigjuar, pasi është një rutinë që ne e kemi trashëguar dhe vazhdimisht pasurohet sfondi edhe me prona të reja dhe mund të ketë gabime. Harroj me përmend drejtori i Financave se ne i kemi adresua rekomandimet e vitit të kaluar dhe nuk do të thotë që punimet e vitit të kaluar, që nëse i kemi pasur 21 nuk është krenari me i zvogëluar 14 sepse këto janë rekomandime për vitin 2019, e nuk janë rekomandime për vitin 2018 kurse ato që përsëriten atëherë ato janë gabime të menaxhmentit. Te 14 rekomandimet ne kemi bërë një plan të veprimit për adresimin e rekomandimit dhe unë mendoj e po dua me ju përgjigj asamblistit Masar Popajt, që asnjëherë kryetari i Komunës Smajl Latifi nuk ka thënë që ka me i plotësua të gjitha rekomandimet, pasi komuna jonë ka pasur edhe raport të modifikuar në periudhën 2000-2007 e madje edhe mohim të opinionit, pra komuna e Rahovecit ka raport nga Zyra Kombëtare e Auditimit edhe me mohim të opinionit pra komuna e Rahovecit ka raport nga Zyra Kombëtare e Auditimit por ka edhe raport edhe me kualifikim të çështjes pra të modifikuar me theksime të çështjes por fatkeqësisht e ka edhe një raport me mohim të opinionit pra nuk i ka plotësua as kriteret minimale për një menaxhim të mirë. Tash ne vitin e ardhshëm unë ju siguroj se raportin për vitin 2020 do të jetë edhe dy herë me i mirë se sa raporti për vitin 2019 që këtë duhet ta regjistroni mirë. Por ne e kemi marr me shume seriozitet me planin e veprimit me i adresua këto rekomandime të cilat janë për vitin 2019 dhe që mundën me i adresua edhe gjatë kësaj periudhe 6-mujore dhe unë besoj që 2021 kur ta trajtojmë në këtë kuvendë, raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për komunën e Rahovecit ka me dal edhe dy herë me i mirë se sa raporti i këtij viti që ka ardh para jush pra 2019.

Afrim Limani – Kryetari i tha të gjitha edhe nuk të ju marr shume kohë, mirëpo e pash të arsyeshme me ju dhanë disa sqarime të cilat kryetari ndoshta nuk pati mundësi me i thanë. E para te keq klasifikimet pyetje që keni bërë pothuajse të gjithë, paraprakisht duhet ta dini një gjë, planifikimi i buxhetit është bërë në vitin 2017 dhe ky është raport i auditimit për vitin 2019. Për shkak të limiteve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe nuk kemi pasur para të mjaftueshme atëherë jemi detyruar që një pjesë të shërbimeve të kategorisë mallra dhe shërbime ta qesim për planifikim për investime kapitale, pra kjo ekskluzivisht është për punëtorët shëndetësor që janë në shërbim të Caritasit dhe një pjesë tjetër është pagesa nga thesari përmes përmbarimeve. Në vitin 2019 ka filluar për herë të parë aplikimi i tatimit në pronën rezidenciale dhe si rezultat i kësaj softueri ka bërë shume gabime me adresimin në fatura p.sh. Unë jam i fshatit Çifllak dhe fatura jem ka ndodh që u shkua në Ratkoc apo dikun tjetër dhe pikërisht këtu dhe të auditori kanë rezultue edhe këto gabime. Normalisht që numri i ankesave kanë qenë krejt të pranura sepse është një gabim teknik që u deshtë me punua. Pra këtu është fjala te tatimi në pronë e jo që nuk ka pasur regjistrime apo verifikime të pronës. Përsëritja e rekomandimeve ë e tha edhe doktori, e vërtet është se dy herë rekomandimet i kemi pasur të përsëritura dhe një rekomandim është te punëtorët e zjarrfikësit dhe kjo është një anomali pasi na punëtorët e zjarrfikësve i pagujmë nga buxheti i komunës se Rahovecit kurse këta janë punëtorë në kuadër të Ministrisë se punëve të brendshme edhe dosjen janë në kuadër të Ministrisë se Punëve të Brendshme. Ky rekomandim është i përsëritur dy herë dhe qasja jonë është e pamundur atje mirëpo lirisht mund të ju them se na e kemi dërgua planin e zbatimit të rekomandimeve të këtij viti në zyrën kombëtare dhe kjo si e gjetur nuk do të funksionoj sepse kemi arrit që në dosjet tona me mundësit tona të shkojmë edhe ti zbatojmë ato ,pra është një rekomandim i zbatuar. Po ashtu Masar Popaj e bëri një pyetje që realisht me obligon të jap një përgjigje, ku ne faqe 6 auditori e ka potencua shume mirë ku sipas auditorit të tri rekomandimet janë të zbatuara, dy janë të përfunduara dhe 13 të tjera janë në procese edhe ato që janë ne proces lirisht mund të them se janë të zbatuara ndërsa 3 rekomandime janë të paarritshme. Ato që kanë qenë në proces në këtë fazë ku jemi ne tash, ato janë të zbatuara.

Rasim Fazliu – Përsëritje për të gjithë të pranishmit në sallë. Pothuajse të gjitha çështjet apo të gjeturat që auditori i ka identifikuar, që mbi 50% e auditimeve janë të vitit 2018. Unë desha me thënë që kjo e gjetur është lehtë mu heq, që me i tregua auditorit që për vitet në vijim me i bë auditimet për kohën që duhet pasi nuk ka efekt që me i bo auditimet e viteve të kaluara kështu që do t'i ndihmonte edhe menaxhmentit, komunës dhe të gjithëve nëse ata e kryejnë në kohën e duhur. Kjo ishte çështja që unë desha me diskutua edhe me ngritë.

Kryetari – Ndoshta i mbeta borxh dikujt pasi nuk ishte pretendimi me ju përgjigj të gjitha pyetjeve të adresuara sot pasi DKA-ja do ju përgjigjet, ju mund të shkruani pyetjen me shkrim dhe përgjigjen shume shpejt mund ta merrni me shkrim dhe nuk ka nevojë që me pritë për ne seancën tjetër, për shkak të kohës dhe jo për diçka tjetër. Po i përgjigjem pyetjes se shtruar z. Rasim Fazliu, pra ne nuk mund të ndryshojmë mendimin e auditorve të brendshëm pasi kanë mbetur me mënyrën e punës së vjetër qysh se kur ka fillua auditimi dhe kanë njëfarë strategjie totalisht të gabuar edhe këtë kam kërkuar edhe ne mandatin e parë dhe sipas tyre se ligji e thotë se kështu duhet të veprojmë. Për mua nuk ka funksionuar as atëherë kurse tash nuk ka me funksionua hiq dhe unë nuk e pranoj mo një rekomandim të përsëritur që auditorët e brendshëm me auditua komunën e Rahovecit pastaj drejtoritë komunale departamentet që me i auditue se çka ka ndodhur para dy vite. Por ata duhet që krejt puna e tyre, strategjie e punës se tyre duhet me qenë në funksion të ndihmës së menaxhmentit të drejtuesve të komunës se Rahovecit. Besoj që ata e kanë kuptuar se ligji nuk ka mbet si para 15 vite, por ligjet ndryshojnë, udhëzimet ndryshojnë, kërkesat ndryshojnë, nevojat ndryshojnë kështu nevojë imediate që Auditori i Brendshëm me na ndihmua neve. Auditori i jashtëm ka për detyrë me na kontrollua neve se a kemi punuar mirë apo keq kurse Auditori i Brendshëm duhet me parandalua që mos me bo veprime të gabuara. Edhe unë pajtohem plotësisht me ato që tha dhe që është shqetësim i Rasimit dhe i gjithë

asamblistëve dhe i drejtuesve të udhëheqjes komunale edhe besoj që nuk ka me u përsërit më në komunën e Rahovecit.

Sali Sallteku - Unë kërkoj mirëkuptimin tuaj, që për shkak të respektit të familjes Hasku, propozoj që të shkojmë me pikën rreth emërimit të Muzeut të qytetit „Ali (Bajram) Hasku,,.

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për emërtimin e Muzeut të Qytetit „Ali (Bajram) Hasku,,.

Kryetari - Faleminderit shumë, falënderoj edhe njëherë praninë e familjareve të ish të burgosurit politik, veteranit të arsimit, atdhetarit të shquar nga komuna e Rahovecit Ali (Bajram) Hasku, i cili ka përjetuar drama, vuajtje përjetime në shërbim të kauzës së çlirimit të Kosovës nga pushtuesi sllav. Është mirë që komisioni për emërtimet në bashkëpunim me drejtorinë e Urbanizmit dhe drejtorinë e Kulturës dhe në pajtim të plotë me Kryetarin e Komunës dhe ekzekutivin ka propozuar një emër të nderuar, për ta nderuar Komunën tonë dhe Muzeun e Qytetit të Komunës tonë, me emrin e një veprimtari, patrioti, ish të burgosuri politik, një veterani të arsimit i cili ka rrezatuar jo vetëm në komunën tonë por veprimtaria e tij dhe rrezja e veprimit të tij kalon kufijtë administrativ të Komunës tonë. Ishte një patriot i çmuar në nivel kombëtar që ka marr mirënjohje, medalje, dekorata dhe tituj nderi edhe nga Komuna e Pejës dhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë në atë kohë z. Sali Berisha. Është nder i madhe që Kuvendi i Komunës së Rahovecit, anëtarët e kuvendit komunal në pajtueshmëri të plotë kanë propozuar që ta zgjedhin për ta emërtuar Muzeun e Qytetit të Komunës së Rahovecit, me emrin Ali (Bajram) Hasku. E di që ka diku një rrugë por besoni që është e pamjaftueshme për të qenë mirënjohës e falënderues për kontributin e madhe që ka dhënë ky njeri ky patriot, ky ish i burgosur, ky veteran i arsimit dhe veteran i patriotizmit Ali (Bajram) Hasku. Pra është mirë që Komuna jonë ka rastin sot për ta nderuar një pinjollë të lirisë që gjithë jeta e tij ka qenë dramë vuajtje dhe kauzë për lirinë e atdheut. Përveç mirënjohjes dhe falënderimit për kontributin e madhe që ka dhënë i ndjeri, patrioti, ish i burgosuri për disa herë, veterani i arsimit, patrioti që për disa dekada ka dhënë kontribut për çështjen dhe të mirën e përgjithshme emërtohet Muzeu i Qytetit, e sigurisht edhe drejtohesha ka i thanë disa fjalë dhe është shumë mirë edhe prezenca e familjareve këtu dhe njerzët me afërm e tij dhe që kanë kontribuar që ta kemi edhe një momentum të mirë dhe që me një vendim solemn unanim ta pagëzojmë Muzeun komunal të Qytetit me emrin Ali (Bajram) Hasku.

Bjondina Kleqka – Faleminderit kryesues, përshëndetje Kryetar, nënkryetar, të nderuar këshilltarë dhe gjithë ju të pranishëm. Para jush e keni propozimin i cili ka ardhur nga Kryetari i Komunës përkatësisht nga Komisioni për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe institucioneve komunale për emërtimin e muzeut të qytetit me emrin e personalitetit të shquar të çështjes kombëtare dhe veteranit të arsimit Ali (Bajram) Hasku. Po ashtu bashkangjitur me propozimin e gjeni edhe një historik të shkurtër për jetën dhe veprimtarinë e tij. Emërtimin e muzeut të qytetit me emrin e atdhetarit Ali (Bajram) Haskut, i cili punojë si mësimdhënës në shume treva shqiptare dha kontribut të madhe në zgjedhjen e çështjes kombëtare në trevat e ish Jugosllavisë, për çka edhe shume shpesh u burgosë dhe u persekutua, do të i bënte nder Komunës së Rahovecit dhe vendit tonë, familjareve e sidomos kulturës shqiptare., prandaj presim rekomandimet dhe aprovimin tuaj.

Ali Morina – Faleminderit kryesues, i nderuar Kryetar, nënkryetar, drejtor të drejtorive komunale, te nderuar kolegë asamblistë, e nderuara dhe shume e respektuara familja Hasku. Grupi parlamentar i AAK-së i japim mbështetje këtij propozimi.

Fehmi Cena – Propozimit për emërtimin e Muzeut të qytetit me emrin e atdhetarit Ali (Bajram) Hasku është i qëlluar dhe i arsyeshëm. Emri Ali Hasku është i njohur për neve qysh nga bankat shkollore përmes mësuesve, nga baballarët tani si intelektual, si mësues lirisdashës, patriot dhe i përndjekur politikisht nga pushteti jugosllav. Atë do ta kujtojmë gjithmonë si njëri me vlera të larta intelektuale, lirisdashës e patriotike nga treva jonë. Emërtimi i muzeut të qytetit me emrin Ali (Bajram) Hasku i bën nder qytetit të Rahovecit,

komunës tonë dhe gjithë shoqërisë. Prandaj edhe ne emër të grupit të delegateve nga Lidhja Demokratike e Kosovës e përkrahim plotësisht këtë.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, fillimisht edhe unë përshëndes familjen e atdhetarit Ali (Bajram) Hasku. Gjithashtu edhe ne ndihemi të privilegjuar që na është dhënë rasti që me nderua emrin e muzeut me emrin e atdhetarit dhe veprimtarit të çështjes kombëtare Ali (Bajram) Hasku. Kështu që në emër të grupit të PDK-së e mbështesim propozimin e kryetarit për emërtimin e muzeut të qytetit me emrin Ali (Bajram) Hasku.

Dervish Çadraku – Faleminderit kryesues, kur pash familjen e veprimtarit të shquar Ali (Bajram) Hasku dhe u ulen prapa nesh këtu në sallë të Kuvendit, u kthye kujtesa prapa kur isha fëmijë në shkollën fillore, por prindi im më ka folur atëherë për Ali Haskun si patriot e atdhetar i Rahovecit, i cili detyrimisht ka ikur atëherë nga Rahoveci dhe ka shkuar në Pejë, për një burrë të fortë, trim, atdhetar i cili ka dhënë shumë për Rahovecin, për Kosovën dhe çështjen kombëtare dhe është nder për Rahovecin, për neve dhe për gjithë atdhedashësit që ta ketë këtë emblemë komuna jonë në vendin ku e kemi parapërcaktuar prandaj ne si grup parlamentar i Vetëvendosjes e përkrahim dhe jemi shumë dakord për këtë.

Kryesuesi – Faleminderit shumë z. Çadraku, të nderuar kuvendarë tani e qesim në votim. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e tetë e rendit të ditës, pra shqyrtimi dhe aprovimi i propozimit të Kryetarit pra emërimin e muzeut të qytetit të atdhetarit të shquar Ali (Bajram) Hasku. E nderuar familje Hasku, faleminderit shumë për prezencën tuaj! Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-71510057-07998-0 në Rahovec.

Afrim Oruqi – Faleminderit Kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, të nderuar anëtarë të kuvendit komunal të Rahovecit. Sipas ligjit në fuqi, para jush keni propozim vendimin të kryetarit të komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër prej 1-15 vite të pronës komunale shtetërore në zonë kadastrale në Rahovec me sipërfaqe prej 25 ari e 77 m². Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatshkurtër është ruajtja dhe rritja e vlerës komunale me mundësi që qytetaret e komunës tonë të vetëpunësohen. Afati kohor për dhënien e pronës është prej 1-15 vite. Komuna e Rahovecit do të përkujdeset që pas procedurave të ankandit publik të shkruaj një kontratë me përfituesin. Çmimi fillestar i pronës është i përcaktuar sipas rregullores. Obligohet drejtoria e Bujqësisë dhe Gjeodezisë që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik të kryejë procedurat tjera obligative. Ftojë anëtarët e kuvendit që pas shqyrtimit të vendimit, të aprovoje vendimin e kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, ne gjithsesi e kemi trajtuar këtë pikë në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe kemi rekomanduar ë për të tri pikat të i rekomandohet kuvendit për 10 vite. E qesim në votim pikën e 5-të të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e 5-të e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-71510057-04475-0 në Rahovec.

Afrim Oruqi – Edhe kjo parcelë gjendet në aksin rrugor Rahovec- Malishevë, në vijë ajrore 300 m mbrapa ordinancës së Dr. Avdyllit në brendësi të zonës. Qëllimi i dhënies së pronës është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës komunale dhe punësimi i njerëzve që i marrin me qera ato prona. Afati kohor për dhënien e pronës është 10 vite. Komuna e Rahovecit e ruan të drejtën që në çdo kohë të shkëputë kontratën të cilën do ta formoj kryetari me fituesin. Çmimi caktohet sipas rregullores. Ftojë anëtarët e kuvendit që të aprovojnë propozim vendimin e kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale.

Kryesuesi – Faleminderit Drejtor, gjithashtu edhe kjo pikë është trajtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa. Edhe këtë pikë e qesim në votim. Konstatoj se unanimisht aprovohet edhe pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale P-71510057-04381-0.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtare të Kuvendit. Para jush keni propozim vendimin e kryetarit të komunës për dhënien e pronës me qera prej 10 vite. Prona gjendet në zonën kadastrale në Rahovec me numër 04381-0 me sipërfaqe 12 ari e 8m². Qëllimi i dhënies së pronës është ruajtja dhe rritja e vlerës. Kjo pronë gjendet skaj rrugës që shkon për fshatin Potoqan. Vija ajrore prej Jaha petrol është 1 km në brendësi të zonës. Komuna e Rahovecit e ruan të drejtën që në çdo kohë të ndërpres kontratën me përfituesit e kësaj prone. Çmimi fillestar i pronës caktohet sipas rregullores në fuqi. Obligohet kryetari i komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik të nënshkruaj kontratë me përfituesit e kësaj prone. Ftojë anëtarët e kuvendit komunal që të votojnë propozim vendimin e kryetarit. Faleminderit

Kryesuesi – Faleminderit shumë drejtor, edhe kjo pikë sikur dy të tjerat do të jepet në shfrytëzim për 10 vite. E qesim në votim pikën e shtatë të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e shtatë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës për shfuqizimin e vendimit 01-Nr.90/20 të datës 29.07.2020 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë.

Kryesuesi – Të nderuar anëtarë të Kuvendit, për shkak të një problemi teknik të procedurave tek vendimi që e keni pasur edhe ju në material të shkruar edhe për këtë mbledhje na kërkohet vetëm aprovimi i shfuqizimit të atij vendimi. Ndërsa në mbledhjet e radhës e shohim dhe e aprovojmë. E qesim në votim pikën e nëntë të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e nëntë e rendit të ditës.

Ali Zhuniqi – Për shkak të konsideratës të familjes Hasku që ishin prezentë në nderim të emërimit të Muzeut të qytetit nuk desha me replikua me kryetarin lidhur me konkursin por më duhet me ja sqarua në lidhje me përgjigjen që nuk ma dha. Sipas informacioneve që posedojmë dhe të cilat janë të supozuara, në të njëjtën pozite kemi një person me emrin Silvana Kastrati që vjen nga një fshat i komunës së Rahovecit që për njëjtën pozite është siguruar vendi. Kështu që kjo është gjendja që për shkak të konsideratës dhe prezencës së familjes Hasku nuk desha të replikoj me kryetarin.

Kryesuesi – Gjithsesi unë po dua me ju falënderua për kontributin jo vetëm të z. Zhuniqi por të secilit deputet që nëpër mbledhje që po kemi po dakordohemi për rrethana e situata të cilat po na krijohen. Është e vërtetë z. Zhuniqi që pyetjet e kuvendareve duhet me dhanë përgjigje por është e drejtë edhe e drejtorëve e ekzekutivit që të adresojnë në ditët në vijim, që është gjithçka legjitime. Unë ju falënderoj të gjithëve për kontributin tuaj! Mirë u pafshim për mbledhjen e radhës!

01 Nr. ____/2020
Rahovec, 29.09.2020

Procesmbajtësi:

Agim Hoti

KRYESUESI

Afrim Dina



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Shërbime Publike
Odeljenje za Opštinske Javne Usluge
Department of Municipal Public Services

Datë/Datum/Date:	23.09.2020
Referenc-ë	
Për/Za/To:	Shefat e Grupeve Parlamentare në kuvendin e komunës së Rahovecit, z.Rasim Fazliu, z.Ali Morina, z.Fehmi Cena, z.Dervish Çadraku
CC:	z.Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit z.Afrim Dina, Kryesues i Kuvendit Komunal në Rahovec
Përmes/Preko/Through:	
Nga/Od/From:	z.Përparim Krasniqi, Drejtor për Shërbime Publike
Subjekti/Predmet/Subject:	Projektet infrastrukturore për vitin 2021

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Për vitin 2021 planifikojmë këto projekte infrastrukturore, sipas planit të punës së DSHP-së për vitin 2021

Lista e vendbanimeve të komunës sonë ku janë paraparë të ndërtohen segmente të kanalizimit, projekti i kanalizimit ka vazhduar në vitin 2020 edhe 2021.

Kodi: 48032-Përmirësimi i kanalizimit në Pastasel dhe vendbanimet tjera të komunës së Rahovecit

1	Rahovec	3125	m'
2	Ratkoc	2430	m'
3	Nashpall	165	m'
4	Celine	280	m'
5	Zoqishte	770	m'
6	Xerxe	1543	m'
7	Senoc	730	m'
8	Malesi e Vogel	800	m'
9	Opterushe	1120	m'
10	Nagac	135	m'
11	Krushe e Madhe	1080	m'
12	Kramavik	241	m'
13	Hogë e Vogel	185	m'
14	Fortese	1492	m'
15	Drenoc	110	m'
16	Brestoc	785	m'
17	Pastasel	730	m'
		15721	m

Totali: 16 km kanalizim

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Shërbime Publike
Adresa: 8 Dëshmorët e Pashtrikut p.n. Rahovec, Kosovë
Tel: +383 29 276 943
E-mail: info@komuna-rahovec.org

2. Projekti me bashkëfinancim me MAPL për zgjerimin e rrjetit të kanalizimit! Projekti është i vitit 2019 dhe vazhdon edhe në vitin 2020 dhe 2021.

Kodi 49862-Ndertimi dhe rregullimi i kanalizimeve fekale (gropave septike)

NR.	REKAPITULLIM	Gjatësia (m')
1	FORTESE	856.00
2	PATAQAN I POSHTËM	1,110.00
3	PATAQAN I EPËRM	817.00
4	BRATOTIN	935.00
5	SENOG	105.00
6	POLLUZHE	127.00
7	DEJN	560.00
8	DOBIDOL	1,740.00
9	KRUSHË E MADHE	565.00
10	RATKOC	174.00
11	KRAMOVIK	3,800.00
12	MRASOR	830.00
13	RAHOVEC	2,415.00
14	XËRXË	300.00
Gjatësia Totale		14,334.00

3.Projekti me bashkëfinancim nga Grandi i Përformances për ndërtimin e rrugëve lokale në komunën e Rahovecit

Loto 1, Ndërtimi i rrugëve lokale

REKAPITULLIM TOTAL		
Poz.	Përshkrimi	Gjatesia (m)
A	NDËRTIMI I RRUGËS PETRO MARKO NË FSHATIN VRAJAK	565 m
B	NDËRTIMI I RRUGËS ALI SHABANI NË FSHATIN MALËSI E VOGËL	500 m
C	NDËRTIMI I RRUGËS MEHEDIN MORINA NË FSHATIN GEXHË	175 m
D	NDËRTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN RATKOC	3480 m
E	NDËRTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN DEJNË	800 m
F	NDËRTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN KRAMOVIK	660 m
G	NDËRTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN ÇIFLLAK	735 m
H	NDËRTIMI I RRUGËS SHABAN JASHARI NË FSHATIN DOBIDOL	80 m
TOTALI LOT I:		6995 m

KOMUNA RAHOVEC

Drejtorja për Shërbime Publike
Adresa: 8 Dëshmorët e Pashtrikut p.n. Rahovec, Kosovë
Tel: +383 29 276 943
<http://www.komuna-rahovec.net>

Lot 2, Ndërtimi i rrugëve lokale

REKAPITULLIM TOTAL		
A	NDËRTIMI I RRUGËVE NË QYTETIN E RAHOVECIT	1505 m
B	NDËRTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN XËRXË	620 m
C	NDËRTIMI I RRUGËS NË FSHATIN POLLUZHË	110 m
D	NDËRTIMI I RRUGËS NË FSHATIN PASTASELË	250 m
E	NDËRTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN DRENOC	890 m
F	NDËRTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN FORTESE	835 m
G	NDËRTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN PATAQAN I POSHTËM	460 m
H	NDËRTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN SENOC	620 m
I	NDËRTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN SAPNIQ	340 m
TOTALI LOT II:		5630 m

Lot 3, Ndërtimi i rrugëve lokale

REKAPITULLIM TOTAL		
Poz.	Përshkrimi	Gjatësia
A	NDËRTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN RETIJË E ULËT	625 m
B	NDËRTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN BRESTOC	160 m
C	NDËRTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN CELINË	590 m
D	NDËRTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN KRUSHË E MADHE	3360 m
E	NDËRTIMI I RRUGËVE NË FSHATIN OPTERUSHË	370 m
TOTALI LOT III:		5105 m

Arsyetim: Totali i kilometrave të rrugëve është 17,8 km rrugë me elemente betoni, përveç elementeve betoni, ka rrugë që do të trajtohet edhe me instalime nëntokësore sidomos me kanalizim dhe ujë të pijshëm.

Loto 1 ka gjithsej 8 vendbanime me gjithsej 33 rrugë me gjatësi 7 km rrugë.

Loto 2 ka gjithsej 9 vendbanime me gjithsej 38 rrugë me gjatësi 5,7 km rrugë.

Loto 3 ka gjithsej 5 vendbanime me gjithsej 37 rrugë me gjatësi 5,1 km rrugë.

Kodi 40818- Ndërtimi i trotuareve në komunën e Rahovecit

4. Projekti i trotuareve është kontratë në vazhdim, ku janë të përfshira 10 pozicione për vitin 2021.

Në vitin 2021 planifikojmë disa trotuare të tjerë, si në rrugë të tjera që janë shumë të nevojshme, e që janë kërkesë e këshillave të fshatrave dhe të lagjeve urbane.

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Shërbime Publike
Adresa: 8 Dëshmorët e Pashtrikut p.n. Rahovec, Kosovë
Tel: +383 29 276 943
E-mail: info@komuna-rahovec.net

REKAPITULIM TOTAL 2021		
1	NDËRTIMI I TROTUARIT NË RRUGEN TAFIL ZYBERAJ	300 m
2	NDËRTIMI I TROTUARIT NË GEXHË-MALËSI E VOGËL	600 m
3	NDËRTIMI I TROTUARIT BREND FSHATIT FORTESE	550 m
4	NDËRTIMI I TROTUARIT FORTESE-SAPNIQ	500 m
5	NDËRTIMI I TROTUARIT NË FSHATIN POTOQAN I ULËT	500 m
6	NDËRTIMI I TROTUARIT NË FSHATIN NASHPALLË	1100 m
7	NDËRTIMI I TROTUARIT NË DRENOC	700 m
8	NDËRTIMI I TROTUARIT NË SENOC	435 m
9	NDËRTIMI I TROTUARIT NË PASTASEL	700 m
10	NDËRTIMI I TROTUARIT NË RRUGËN DEJN-RATKOC	750 m

Për sqarim; Disa nga këto kërkesa për trotuare janë bazuar në diskutimet dhe kërkesat e këshillave të fshatrave gjatë diskutimeve dhe me debatet me KPF-në.

Kodi 49898 Ndërtimi dhe zgjerimi i ndriçimit publik në komunën e Rahovecit

Përfshin këto vendbanime, pjesa më e madhe është qyteti i Rahovecit, pastaj edhe të gjitha vendbanimet e komunës sonë.

Me prioritet në projekt janë të përfshira rrugët kryesore në ndriçim publik në shtylla metalike me instalime nëntokësore, ndërsa vendbanimet tjera janë të përfshira në rrjetin ajror të ndriçimit publik.

6. Projekti i meremetimit të rrugëve dhe trotuareve, ka qenë vazhdimësi e planifikimeve buxhetore edhe të mëhershme, mirëpo, në vitin 2018 e kemi ndarë në 3 Lote projektin, njëri Lot 1 ka të bëjë me asfaltimin e rrugëve dhe rregullimin e pusetave në rrugë, Lot 2 ka të bëjë me rregullimin e rrugëve me kubëza betoni dhe trotuareve, ndërsa Lot 3 ka të bëjë me ndërtimin e mureve mbrojtëse në disa vende që kanë qenë kërkesë e vazhdueshme e këshillave të

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Shërbime Publike
Adresa: 8 Dëshmorët e Pashtrikut p.n. Rahovec, Kosovë
Tel: +383 29 276 943
<http://www.komuna-rahovec.net>

fshatrave dhe lagjeve të qytetit. Planifikohet me këtë projekt të vazhdohet edhe në vitin 2021 sipas kërkesave të qytetarëve.

Me respekt!

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Shërbime Publike
Adresa: 8 Dëshmorët e Pashtrikut p.n. Rahovec, Kosovë
Tel: +383 29 276 943
<http://www.motzenhausen.com>



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije / Ministry of Finance

Zyra e Ministrit / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister

DATË/A:	14.09.2020
PËR/ZA/TO:	Kryetarët e Komunave, Drejtorët e Drejtorive Komunale për buxhet dhe financa, Zyrtarët kryesor financiar të komunave
NGA/OD/FROM:	Hykmete Bajrami, Ministre e Financave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkorja Buxhetore 2021/03


Të nderuar,

Më lejoni t'ju falënderoj për kontributin e juaj në rishikimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2021-2023, që paraqet bazën për hartimin e projektbuxhetit për vitin 2021.

Për arsye të nën-performancës së të hyrave buxhetore si rezultat i pandemisë COVID-19, Ministria e Financave ka iniciuar rishikimin e KASH-it 2021-2023. Qëllimi kryesor i rishikimit të KASH-it ka qenë adaptimi i prioriteteve afatmesme të qeverisë si rezultat i pandemisë. Qeveria e Kosovës bazuar në prioritetet afatmesme është e përkushtuar që duke ruajtur stabilitetin fiskal të përkrah kërkesat e organizatave buxhetore, brenda orientimit sektorial buxhetor të përcaktuar me KASH 2021-2023.

Në vijim mund të gjeni Qarkoren Buxhetore 2021/03, e cila ofron kufijtë buxhetor për secilën komunë. Ministria e Financave mbetet në dispozicionin e juaj për të ofruar mbështetjen e nevojshme gjatë procesit të hartimit të projektligjit të buxhetit për vitin 2021.

Me respekt!


Hykmete Bajrami
Ministre e Financave

Qarkorja Buxhetore 2021/03

1. Qëllimi

Ministria e Financave është e autorizuar dhe përgjegjëse që në përputhje me nenin 20 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048, të nxjerrë qarkore buxhetore për cilëndo ose të gjitha organizatat buxhetore me të cilat sigurohen udhëzime për përgatitjen e Buxhetit të Kosovës.

Në mbështetje të kësaj dispozite ligjore, Ministria nxjerr Qarkoren e tretë Buxhetore 2021/03, ku ofrohen udhëzimet për hartimin e buxhetit për vitin 2021 dhe vlerësimet për vitet 2022-2023, kalendarin kohor indikativ si dhe kufijtë buxhetor për vitin 2021 dhe vlerësimet për vitet 2022-2023 për çdo komunë.

2. Konteksti për përgatitjen e buxhetit për 2021-2023

Korniza për buxhetin e vitit 2021 bazohet në KASH-in e rishikuar 2021-2023 që është aprovuar nga Qeveria e Kosovës me datë 14.09.2020, bazuar në prioritetet afatmesme të Qeverisë dhe kornizën makro-fiskale për vitet 2021-2023. Qeveria është e përkushtuar që duke ruajtur stabilitetin fiskal brenda orientimit sektorial buxhetor të përcaktuar me KASH 2021-2023, sipas prioriteteve të përcaktuara përmes Deklaratës së Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë.

Projeksionet fiskale të KASH 2021-2023 kanë përcaktuar burimet e financimit që Qeveria mund të ketë në dispozicion për shpenzim në vitin 2021, dhe vlerësimet e viteve vijuese. Çdo tejkalim i kufijve të shpenzimeve mbi kufijtë e kësaj qarkoreje e bën të detyrueshëm ndryshimin përkatësisht rritjen e burimeve të financimit, gjegjësisht ndryshimin e politikave tatimore për të arkëtuar të hyra shtesë.

Gjatë zhvillimit të procesit buxhetor, duhet të marrim parasysh edhe zotimet tona në raport me institucionet financiare ndërkombëtare. Në këtë kontekst, Qarkorja Buxhetore 2021/03 është hartuar në pajtim me obligimet nga marrëveshjet financiare ekzistuese dhe të atyre në negociim, dhe reflekton përkushtimet për drejtimin e politikave fiskale të përcaktuara në pajtim me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN).

3. Kufijtë buxhetor dhe kriteret e përgjithshme për përgatitjen e buxhetit për vitin 2021-2023

Komunat duhet të kenë parasysh që gjatë përgatitjes së propozim buxhetit t'u japin përparësi prioriteteve zhvillimore dhe projekteve të cilat janë në vazhdimësi nga vitet paraprake dhe që kanë obligime kontraktuale.

Shpenzimet buxhetore në periudhën afatmesme priten të stabilizohen pas pandemisë COVID-19 dhe gradualisht të rikthehen në nivelet e rritjes historike. Viti 2021 karakterizohet nga një rënie në disa prej kategorive të shpenzimeve kryesisht për shkak të efektit bazë të vitit 2020, që ka pasur një rritje të theksuar në disa kategori si rrjedhojë e masave stimuluese fiskale të qeverisë.

Procesi i planifikimit të buxhetit duhet të përfshijë këto aspekte:

- Buxhetimi në nivel të programeve dhe nën-programeve, në përputhje me strukturën ekzistuese të planit kontabël;
- Përmirësimet në qasjen e buxhetimit të orientuar drejt rezultateve dhe performancës (Aneks 3);

- Zbatimi i konceptit shumëvjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale;
- Prezantimi tabelar mbi burimet e financimit dhe strukturën e shpenzimeve sipas kategorive të shpenzimeve për vitin 2021 dhe projeksionet për vitet 2022-2023;
- Gjatë procesit buxhetor vëmendje e shtuar duhet t'i jepet zbatimit të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe praktikave të mira buxhetore me fokus në këto çështje:
 - Plotësimin e të dhënave që kërkohen në sistemet buxhetore SZHMB dhe PIP;
 - Eliminimin e keqklasifikimit të shpenzimeve buxhetore;
 - Projektet e reja të propozuar të jenë projekte të përgatitur në përputhje me Manualin e PIP dhe **Udhëzimin Administrativ MF-Nr.06/2019 për Kriteret Përzgjedhëse dhe Prioritizimin e Projekteve Kapitale**;
- Projektet e propozuar të jenë të maturuar (projekte të gatshëm për zbatim);
- Regjistrimi i zotimeve shumëvjeçare në SIMFK;
- Buxhetimi i projekteve kapitale duhet të bëhet në përputhje me **Udhëzimin Administrativ MF-Nr. 04/2019 për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve të Projekteve Kapitale**, ku pjesë e kostos së projektit janë edhe shpenzimet e shpronësimit. Me këtë rast, organizatat buxhetore, pas një analize paraprake duhet të planifikojnë shpenzimet e shpronësimit në kuadër të kostos totale të projektit.
- Të gjitha Komunitatet duhet të respektojnë Ligjin Nr. 05/L-100 për Ndihmë Shtetërore dhe të mos parashohin kurrfarë mbështetje për entitete të ndryshëm që shtrembëron ose rrezikon ta shtrembërojë konkurrencën.

Shpenzimet janë planifikuar në atë mënyrë që të jenë në respektim të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe të kompensojnë deficitin e tejkaluar mbi rregullën fiskale në 2020.

Shpenzimet rrjedhëse: Komunitatet duhet të bëjnë kërkesat e tyre përbrenda kufizimeve buxhetore. Është thelbësore që të gjitha komunitetet t'u përmbahen kufijve të dhënë për vitin 2021 dhe vlerësimet për vitet 2022-2023. Te kategoria e shpenzimeve për paga dhe shtesa komunitetet duhet të respektojnë ndarjet buxhetore dhe mbajtjen e nivelit të punësimit brenda numrit të aprovuar dhe buxhetit në dispozicion në kuadër të kategorisë paga dhe shtesa.

Shpenzimet kapitale - Masa monetare e shpenzimeve për këtë kategori kërkohet të financohen me prioritet projektet të cilat janë në vazhdimësi nga vitet paraprake dhe që kanë obligime kontraktuale.

Komunitatet gjatë përgatitjes së buxhetit të tyre për vitin 2021-2023 duhet të marrin parasysh kufijtë buxhetore të dhënë në tabelën 1.

Projektet kapitale të filluara nga vitet e kaluara, të cilat kanë krijuar obligime kontraktuale mbi mjetet e buxhetuara për komunitetet përkatëse, duhet të përfshihen brenda buxhetit për vitet 2021-2023.

Siç u tha, komunitetet duhet me prioritet të buxhetojnë obligimet, kurse hapësira e lirë fiskale brenda kufirit buxhetor mund të shfrytëzohet për projekte/aktivitete të reja. Çdo mosreflektim i obligimeve mbetet në përgjegjësi të institucionit përgjegjës. Nëse propozim-projektet e reja nuk zbatojnë parimet e lartcekura dhe rregullat e përcaktuara për plotësimin e të dhënave në PIP si dhe të zbatojnë kërkesat e UA për Kriteret Përzgjedhëse të Projekteve Kapitale dhe UA për Definimin e Projekteve Kapitale, në përputhje me ligjin dhe rekomandimet e auditorit, MF është e detyrues të heq nga buxheti ato propozim-projekte. Gjithashtu, kostoja e shpronësimit duhet të buxhetohet brenda kostos totale të projektit të propozuar.

Me buxhetin e vitit 2020 në nivel qendror është larguar numri fiktiv i të punësuarve (që nuk mbulohet me buxhet), pra numri i të punësuarve në nivelin qendror është sjellur në nivelin i cili ka përfshirë numrin aktual të punësuarve si dhe atyre që janë në procesin e rekrutimit. Përmes kësaj qarkoreje, në përputhje me vendimin e Komisionit të Granteve kërkohet nga Komunitatet që të reduktojnë numrin e të punësuarve në nivelin i cili mbulohet me buxhet në kuadër të kategorisë paga dhe shtesa, duke

përfshijtur numrin e të punësuarve që mbulohet nga granti specifik për Arsim dhe Granti specifik për Shëndetësi. Prandaj, Komunitat duhet të paraqesin në MF numrin aktual të punëtorëve si dhe të atyre në proces të rekrutimit, në total të OB-lokale si dhe sipas nën-programeve buxhetore.

Të gjitha komunitat duhet me prioritet të buxhetojnë brenda hapësirë fiskale të gjitha obligimet dhe detyrimet e papaguara nga vitet e mëhershme.

Më poshtë në Tabelën 1 janë kufijtë buxhetor për komunitat. Për detajet e financimit komunal dhe shumat e granteve sipas vendimit të Komisionit të Granteve mund të konsultohet pjesa komunale (pjesa IV) e Rishikimit të KASH 2021-2023. Në aneksin 1 është paraqitur kalendari buxhetor për Komunitat. Aneksi 2 paraqet tabelat e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, kurse Aneksi 3 paraqet Indikatorët e Performancës.

Struktura e shpenzimeve për vitin 2021											Struktura e shpenzimeve për vitin 2021-2023											Struktura e shpenzimeve për vitin 2022							Struktura e shpenzimeve për vitin 2023						
Nr.	Komunat	Nr. i te punësuar ve	Paga dhe shësa	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere	Shpenzime kapitale	Klauzola e Investimeve	Gjithshj shpenzime kapitale	Gjithshj 2021	Nr. i te punësuar ve	Paga dhe shësa	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere	Shpenzime kapitale	Total 2022	Gjithshj 2022	Nr. i te punësuar ve	Paga dhe shësa	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere	Shpenzime kapitale	Gjithshj 2023										
1	Deçan	878	5,556,738	1,582,859	156,000	140,000	2,506,703		2,506,703	9,942,300	878	5,572,075	1,652,504	158,453	149,192	4,122,313	11,877,804	11,654,536	878	5,599,935	1,621,988	165,055	157,968	4,485,553	12,030,499										
2	Dragash	777	4,780,466	966,641	130,000	200,000	2,779,508		2,779,508	8,856,615	777	4,793,660	1,009,173	132,044	213,132	3,854,051	10,240,339	10,002,059	777	4,817,628	990,537	137,546	225,669	4,107,050	10,278,429										
3	Forizaj	2,411	15,805,932	5,050,000	699,680	715,500	9,213,892	2,723,503	11,937,395	34,208,507	2,411	15,849,556	5,272,197	710,681	762,478	14,356,908	37,521,537	36,951,821	2,411	15,928,804	5,174,838	740,293	807,330	15,487,829	38,139,093										
4	Fushë Kosovë	772	5,096,345	1,712,670	250,000	355,000	3,578,670		3,578,670	10,992,685	772	5,110,411	1,788,026	253,931	378,309	4,844,717	12,555,972	12,375,394	772	5,135,963	1,755,008	264,511	400,562	5,156,055	12,712,099										
5	Gjakovë	2,252	14,150,978	3,240,000	586,800	550,500	7,802,302		7,802,302	26,330,580	2,252	14,190,035	3,382,558	596,026	586,645	11,100,389	30,382,917	29,855,652	2,252	14,260,985	3,320,094	620,860	621,153	11,844,939	30,668,032										
6	Gjilan	2,478	15,894,494	4,112,000	671,500	790,000	6,266,743		6,266,743	27,734,737	2,478	15,938,363	4,292,925	682,058	841,870	9,011,010	31,240,710	30,766,226	2,478	16,018,055	4,213,650	710,477	891,392	9,782,078	31,615,651										
7	Gilgoc	1,325	8,700,000	1,988,380	232,508	370,000	4,108,446		4,108,446	15,399,334	1,325	8,724,012	2,075,868	236,164	394,293	5,777,106	17,519,566	17,207,442	1,325	8,767,632	2,037,533	246,004	417,487	6,141,759	17,610,415										
8	Hani i Elezit	237	1,602,781	335,258	67,000	75,000	440,127		440,127	2,520,166	237	1,617,232	350,009	68,053	79,924	987,669	3,154,853	3,102,888	237	1,625,318	343,546	70,889	84,626	1,070,375	3,194,754										
9	Istog	972	6,309,800	1,350,000	202,000	310,000	2,904,191	1,673,122	4,577,313	12,749,113	972	6,327,215	1,409,399	205,176	330,354	4,189,837	12,694,214	12,461,981	972	6,358,851	1,383,372	213,725	349,787	4,492,124	12,797,859										
10	Jumk	163	1,147,799	172,900	36,200	30,500	159,305		159,305	1,546,704	163	1,150,967	180,507	36,769	32,503	419,112	1,854,807	1,819,857	163	1,156,722	177,174	38,301	34,414	459,840	1,866,452										
11	Kaçanik	801	5,289,705	800,000	212,769	250,000	2,230,125		2,230,125	8,782,599	801	5,304,305	835,200	216,114	266,415	3,432,404	10,236,737	10,054,437	801	5,330,826	819,776	225,119	282,086	3,650,041	10,307,848										
12	Kamenicë	1,186	7,300,000	1,354,350	195,000	211,000	1,665,070		1,665,070	10,725,420	1,186	7,320,148	1,413,941	198,966	224,854	3,462,245	12,831,877	12,619,253	1,186	7,356,749	1,387,830	206,319	238,081	3,729,852	12,918,830										
13	Klinë	948	6,297,124	1,211,000	180,000	305,000	2,665,140		2,665,140	10,658,263	948	6,314,504	1,264,283	182,830	325,026	4,002,136	12,304,713	12,088,779	948	6,346,076	1,240,936	190,448	344,145	4,258,222	12,379,828										
14	Leposaviq	569	2,206,175	425,770	64,000	70,000	1,547,239		1,547,239	4,313,184	569	2,212,264	444,504	65,006	74,596	1,904,523	4,849,668	4,700,893	569	2,223,325	436,295	67,715	78,984	2,035,237	4,841,557										
15	Lipjan	1,525	9,574,000	1,700,000	280,000	500,000	4,665,155		4,665,155	16,719,155	1,525	9,600,424	1,774,799	284,402	532,829	6,807,412	19,317,183	18,999,867	1,525	9,648,426	1,742,025	296,252	564,172	7,178,427	19,429,302										
16	Malishevë	1,297	8,363,200	1,529,526	455,000	400,000	4,153,031		4,153,031	14,900,757	1,297	8,386,282	1,596,824	462,154	426,263	6,051,169	17,219,393	16,922,692	1,297	8,428,214	1,567,336	481,410	451,338	6,406,889	17,335,187										
17	Mamushë	156	1,120,022	324,960	31,000	40,000	190,421		190,421	1,706,403	156	1,143,168	339,258	31,487	42,626	458,590	2,064,769	2,015,131	156	1,148,884	332,993	32,799	45,134	507,589	2,067,399										
18	Mitrovicë	1,992	12,599,661	2,962,493	457,214	586,114	4,120,337		4,120,337	20,725,819	1,992	12,634,436	3,092,841	464,403	624,597	6,650,602	23,850,105	23,466,879	1,992	12,697,608	3,035,727	483,753	661,338	7,158,651	24,037,077										
19	Novobërdë	352	2,106,144	303,335	69,259	49,521	280,164		280,164	2,808,423	352	2,142,400	327,122	70,348	52,772	490,859	3,137,767	3,083,141	352	2,152,750	321,081	73,279	55,877	557,811	3,160,798										
20	Obiliq	645	4,273,658	993,930	316,675	830,000	4,776,533		4,776,533	11,190,796	645	4,285,453	1,037,662	321,654	884,496	6,017,877	12,664,297	12,547,143	645	4,306,881	1,018,500	335,056	936,525	6,134,775	12,731,737										
21	Pejë	2,247	14,813,275	3,476,709	748,455	374,500	7,997,226		7,997,226	27,410,165	2,247	14,854,160	3,629,682	760,223	399,089	11,437,413	31,619,822	31,080,566	2,247	14,928,430	3,562,654	791,899	422,565	12,270,874	31,976,422										
22	Podujevë	1,992	12,550,000	2,533,578	420,000	750,050	6,474,728	1,125,298	7,600,026	23,853,654	1,992	12,584,638	2,645,054	426,604	799,297	8,812,927	25,758,355	25,268,519	1,992	12,647,561	2,596,209	444,379	846,314	9,346,124	25,880,587										
23	Prishtinë	4,742	31,000,000	20,100,000	2,100,000	4,000,000	28,592,836		28,592,836	85,792,836	4,742	31,085,835	20,984,388	2,133,018	4,262,632	36,345,894	96,304,059	94,811,767	4,742	31,241,264	20,596,879	2,221,893	4,513,375	39,517,544	98,090,955										
24	Prizren	3,181	20,845,758	6,970,550	1,031,199	950,000	17,991,179		17,991,179	47,788,686	3,181	20,821,066	7,277,250	1,047,412	1,012,375	22,716,246	53,875,693	52,874,349	3,181	20,925,171	7,142,864	1,091,054	1,071,927	24,178,376	54,409,392										
25	Rahovec	1,186	7,622,634	1,715,477	280,500	311,000	4,286,979		4,286,979	14,216,590	1,186	7,643,672	1,790,957	284,910	331,420	5,813,275	16,168,363	15,864,234	1,186	7,681,891	1,757,884	296,781	350,915	6,195,353	16,282,824										
26	Shtërpçë	519	2,355,400	449,730	90,625	45,000	702,508		702,508	3,643,263	519	2,361,901	469,518	92,050	47,955	1,199,450	4,228,802	4,170,874	519	2,373,710	460,847	95,885	50,775	1,294,398	4,275,617										
27	Shtime	665	4,360,904	911,551	220,000	150,000	1,873,300	793,562	2,666,862	8,309,317	665	4,372,940	951,659	223,459	159,849	2,763,612	8,620,343	8,471,519	665	4,394,805	934,085	232,770	169,252	2,958,953	8,689,864										
28	Skenderaj	1,373	8,132,003	1,561,786	230,381	635,000	3,648,418		3,648,418	14,207,588	1,373	8,154,447	1,630,504	234,003	676,693	5,305,865	16,273,336	16,001,512	1,373	8,195,220	1,600,394	243,753	716,498	5,648,670	16,404,535										
29	Suharekë	1,316	8,571,766	2,096,113	358,449	425,000	4,883,176		4,883,176	16,334,504	1,316	8,595,424	2,188,341	364,085	452,905	6,762,338	18,685,225	18,363,092	1,316	8,638,401	2,147,930	379,255	479,546	7,200,115	18,845,247										
30	Viti	1,162	7,437,105	1,918,949	320,000	350,000	2,464,632		2,464,632	12,490,686	1,162	7,457,631	2,003,382	325,031	372,980	3,881,723	14,296,114	14,040,748	1,162	7,494,920	1,966,386	338,574	394,920	4,187,444	14,382,244										
31	Vushtri	1,600	10,691,340	3,218,600	309,035	600,000	4,059,154		4,059,154	18,878,129	1,600	10,720,848	3,360,216	313,894	639,395	6,125,486	21,531,847	21,159,839	1,600	10,774,452	3,298,165	326,973	677,006	6,607,813	21,684,409										
32	Zubin Potok	421	1,590,000	290,248	20,000	91,104	322,393		322,393	2,313,745	421	1,594,388	303,019	20,314	97,086	511,546	2,604,308	2,526,353	421	1,602,360	297,423	21,161	102,797	577,377	2,601,117										
33	Zveçan	368	1,482,406	284,671	30,000	85,000	335,366		335,366	2,217,443	368	1,486,498	297,196	30,472	90,581	637,191	2,613,468	2,541,938	368	1,493,930	291,708	31,741	95,909	698,949	2,612,238										
34	Gracanice	592	3,109,032	1,382,289,																															

Kalendari kohor për nivelin komunal

Organizatat buxhetore të nivelit lokal duhet t'i përmbahen këtij kalendari kohor në përgatitjen e propozim buxhetit:

- 30 Shtator: Aprovimi i propozim Buxhetit Komunal për vitin 2021-2023 nga Kuvendi Komunal,
- 30 Shtator: pas aprovimit të propozim Buxhetit nga Kuvendi Komunal, komunat janë të obliguara të dorëzojnë në Ministrinë e Financave dokumentet si në vijim:
 - Shkresa përcjellëse bazuar në aprovimin e propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal (nënshkruar nga Kryetari i Komunës).
 - Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e propozim-buxhetit komunal për vitin 2021-2023, përfshirë projektet kapitale shumëvjeçare.
 - Tabelat e buxhetit komunal (BDMS dhe PIP):
 - Tabela 4.1 - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve për vitin 2021-2023 (kopje e shtypur prej BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
 - Tabela 4.2 - financimi i projekteve kapitale për vitin 2021 dhe projekteve kapitale shumëvjeçare për vitin 2022-2023 (shtypur nga sistemi PIP, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
 - Tabela 4.3 - plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake (shtypur nga BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
 - Tabela 3.1.B - plani i ndarjeve buxhetore sipas klauzolës së investimeve,
 - Tabela 3.2.B - financimi i projekteve kapitale përmes klauzolës së investimeve,
- Tabelat e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjzinor.

Aneks 2

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinnor

Tabela 1. Numri i punëtorëve në Komunë

Emri i Komunës

Viti	Numri total i stafit	Numri total i stafit që janë gra	Numri total i stafit që janë burra	Paga dhe mëditje/Shuma për gra	Paga dhe mëditje/Shuma për burra
2018					
2019					
2020					
Planifikimi për 2021					

Tabela 2. Planifikimi për vitin 2021 Nivelet e pagave në Komunë

Emri i Komunës

Niveli i pagave	Numri total i stafit në këtë nivel të pagave	Numri i burrave në këtë nivel	Shuma e shpenzuar për burra në këtë nivel	Numri i grave në këtë nivel.	Shuma e shpenzuar për gra në këtë nivel
201-400					
401-600					
600+					

Tabela 3. Numri i përfituesve të subvencioneve apo edhe të shërbimeve ofruara nga organizata buxhetore të drejtorive përkatëse (ku është e aplikueshme)

[Emri i Komunës: Emri i Shërbimit/Subvencionit].

Viti	Buxheti total i shërbimit/subvencionit të caktuar	Numri total i përfituesve	Numri i përfituesve e gra	Numri i përfituesve e burra	Buxheti për gra	Buxheti për burra
2018						
2019						
2020						
Planifikimi për 2021						

Aneksi 3

INDIKATORËT E PERFORMANCËS SË PROGRAMIT BUXHETOR

Organizata buxhetore:

Shembull:

318 Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve		
Objekti 1	Treguesi bazë	Treguesi i synuar
Përmirësimi i mbikëqyrjes së aktiviteteve të minierave dhe atyre prodhuese	Numri i licencave ose numri i inspektimeve	Numri i licencave ose numri i inspektimeve
Aktivitetet:		
<i>Rishikimi i procedurave për zvogëlimin e barrës së ndërveprimi me agjencinë</i>		
<i>Grumbullimi i të dhënave (raportimi) mbi aktivitetet ekonomike për aktivitete inspektimi të synuara më mirë</i>		
<i>Kryerja e hetimeve mbi aktivitetet e paligjshme</i>		
Objekti 2	Treguesi bazë	Treguesi i synuar
Zhvillimi i përmblodhjes së burimeve minerare	Madhësia e vlerësuar e zbulimeve	Madhësia e vlerësuar e zbulimeve
Aktivitetet:		
<i>Mirëmbajtja e kadastrës së minierave dhe bazës së të dhënave GIS që përmbajnë të dhëna gjeografike, gjeologjike dhe të tjera relevante</i>		
<i>Hulumtime për gjetjen e burimeve të reja minerare</i>		
<i>Bashkëpunimi me universitetet dhe bizneset për të përmirësuar hulumtimin në shfrytëzimin e burimeve</i>		



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosoves / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Financave / Ministarstvo za finansije / Ministry of Finance	
Arkiva - Arhiva - Archive	
Nr. Org. Org. Jed. Org. Unit	01
Nr. Prot. Prot. No.	1543
Nr. Hqesve Broj stranica No. pages	7
Data Datum Date	14.09.20
Hyriete PRISHTINE	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Financave / Ministarstvo za finansije / Ministry of Finance

Zyra e Ministrit / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister

DATË/A:	14.09.2020.
PËR/ZA/TO:	Gradonačelnike, direktore opštinskih direkcija za budzet i financije, glavne finansijske službenike opština
NGA/OD/FROM:	Hykmete Bajrami, ministarka finansija
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Budžetski cirkular 2021/03

Poštovani,

Dozvolite mi da vam se zahvalim na vašem doprinosu u revidiranju Srednjoročnog okvira rashoda (SOR) 2021-2023, koji je osnova za izradu nacarta budžeta za 2021. godinu.

Zbog nedovoljnog učinka budžetskih prihoda kao rezultat pandemije COVID-19, Ministarstvo finansija je inicirala revidiranje SOR 2021-2023. Glavna svrha revidiranja SOR-a bilo je prilagođavanje vladinih srednjoročnih prioriteta kao rezultat pandemije. Vlada Kosova, na osnovu srednjoročnih prioriteta, posvećena da održavanjem fiskalne stabilnosti podržava zahteva budžetskih organizacija, u okviru budžetske sektorske orijentacije utvrđenim u SOR 2021-2023.

Priloženo imate Budžetski cirkular 2021/03, koji daje budžetska ograničenja za svaku opštinu. Ministarstvo finansija vam stoji na raspolaganju da pruži potrebnu podršku tokom procesa izrade Nacarta zakona o budžetu za 2021. godinu.

S poštovanjem!

Hykmete Bajrami
Ministarka finansija



Budžetski cirkular 2021/03

1. Cilj

Ministarstvo finansija ima ovlašćenje i odgovornost da u skladu sa članom 20. Zakona o upravljanju javnim finansijama i odgovornosti br. 03/L-048, izdaje budžetske cirkulare za bilo koju ili sve budžetske organizacije koji daju uputstva za pripremu budžeta Kosova.

U skladu sa ovom zakonskom odredbom, ministar izdaje Treći budžetski cirkular 2021/03, koji daje prva uputstva za izradu budžeta za 2021. godinu i procene za period 2022-2023, indikativni vremenski kalendar kao i budžetska ograničenja za 2021. godinu i procene za period 2022-2023. za svaku opštinu.

2. Kontekst za pripremu budžeta za period 2021-2023

Okvir za budžet za 2021. godinu zasniva se na SOR 2021-2023 koji je usvojen od strane Vlade Kosova dana 14.09.2020.god. na osnovu srednjoročnih prioriteta Vlade i makro-fiskalnog okvira za period 2021- 2023. Vlada je posvećena da očuvanjem fiskalne stabilnosti u okviru budžetske sektorske orijentacije utvrđene SOR-om 2021-2023, prema prioritetima utvrđenim kroz Izjavu o srednjoročnim prioritetima Vlade.

Fiskalne projekcije SOR-a 2021-2023 utvrdile su izvore finansiranja koje Vlada može imati na raspolaganju za rashode u 2021. godini i procene za naredne godine. Svako prekoračenje ograničenja rashoda iznad ograničenja ovog cirkulara, čini obaveznim promenu, odnosno povećanje izvora finansiranja, odnosno promenu poreskih politika radi prikupljanja dodatnih prihoda

Tokom razvoja budžetskog procesa, moramo uzeti u obzir i naše obaveze u odnosu na međunarodne finansijske institucije. U tom kontekstu, Budžetski cirkular 2021/03 je izrađen u saglasnosti sa obavezama iz postojećih finansijskih sporazuma i onih u pregovorima, i odražava posvećenost za upravljanje fiskalnim politikama utvrđenim u skladu sa Međunarodnim monetarnim fondom (MMF).

3. Budžetska ograničenja i opšti kriterijumi za pripremu budžeta za period 2021-2023

Opštine treba da uzmu u obzir da u pripremi predloga budžeta daju prioritet razvojnim prioritetima i projektima koji su u toku iz prethodnih godina i koji imaju ugovorne obaveze.

